

Numri i lëndës: 2024:062138

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528836

C.nr.914/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.M.(Z.) nga fshati G., Komuna V., e përfaqësuar nga M.A., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 104.80 €, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.M.nga fshati G., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, për 37 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 01.09.2022 deri me datë 21.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 74 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 30.80 €, në shumë të përgjithshme 104.80 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita kur është ushtruar padia me date 23.02.2024, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 23.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, me vlerë të kontestit 104.80 €.

Me padi, paditësja ka theksuar se është e punësuar tek e paditura dhe për periudhën nga data 03.10.2022 deri më 22.11.2022, ka 22 ditë pune në shkollën “28 Nëntori” si dhe nga data 01.09.2022 deri më 21.11.2022, ka 15 ditë pune në ShFMU “M.S.”, ashtu që në emër të shpenzimeve për ushqim dhe udhëtim, nga gjykata ka kërkuar që për 37 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 74 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 104.80 €, në shumë të përgjithshme 104.80 €. Bazën ligjore e ka mbështetur në Kontratën kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 2017 dhe 2021. Për të mbështetur pretendimet si në padi, si prova ka propozuar: Vërtetimin e punës në shkollën “28 Nëntori”, të datës 09.02.2024, Vërtetimin nga shkolla “M.S.”, nr. 10/24, të datës 02.02.2024, Vërtetimin nga kompanitë e transportit që veprojnë në Komunën e V.së dhe Certifikatën e vendbanimit nr. B 10525595, të datës 23.02.2024. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet që dalin nga KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror e po ashtu, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës / Ministria e Arsimit e ka shkëputur këtë kontratë dhe rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses në tërësi të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike civile, ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës, lartësia e pagës, se nga data 03.10.2022-22.11.2022, paditësja ka qenë e pranishme në punë 22 ditë në shkollën “28 Nëntori” si dhe nga data 01.09.2022-21.11.2022, ka 15 ditë pune në ShFMU “M.S.”, e po ashtu se paditësja ka udhëtuar nga vendbanimi i saj për në vendin e punës në fshatra të ndryshme përkatësisht, në relacionin G.-V.-Vërban dhe anasjelltas, pasi edhe e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar, ngaqë gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditëses.

Meqë baza ligjore e kërkesëpadiës së paditëses mbështetet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), nenin 245, par. 1, në të cilin është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij” lidhur me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, në fuqi nga data 18.04.2017 dhe ajo KKAK në fuqi nga data 21.01.2021, sipas të cilit është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit” si dhe par. 5 të të njëjtit nen, ku është përcaktuar se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara pasi kërkesa e paditëses është për periudhën sa kanë qenë në fuqi KKAK e V.t 2017 dhe 2021 ndërsa, palët kontraktuese të KKAK-së Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” ndërsa, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate.”

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditëses në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
C.nr.914/2024, datë 29.03.2024

G j y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimiit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.